

**Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare - Konferencë Kombëtare**  
**“SFIDAT E ZHVILLIMIT TË TREGJEVE NËN MBIKËQYRJEN**  
**E AMF-SË DHE EDUKIMI FINANCIAR”**  
**24 Maj 2018 - Tiranë, Shqipëri**

**ZHVILLIMI I TREGUT SEKONDAR TË TITUJVE TË QEVERISË, SI NJË MJET**  
**EFIKAS PËR MENAXHIMIN E BORXHIT PUBLIK NË VEND**

**Prof.Asoc.Dr Ines Dika<sup>1</sup>**  
**MSc. Arjana Lleshaj<sup>2</sup>**

***Abstrakt***

Borxhi publik është një instrument që garanton shpërndarjen efiçente të burimeve në ekonomi, si dhe tregon efiçencën e politikave të ndërmarra për sigurimin e të mirave pavarësisht fondeve në dispozicion. Kështu cilësohet borxhi publik i cili është edhe një instrument i menaxhimit të politikave ekonomike në nivel makro. Por nga ana tjetër financimi i tij nga brenda vendit, nga emetimi i instrumentave financiarë qeveritar apo huamarrja e brendshme tregon nivelin e zhvillimit dhe aftësinë e ekonomisë për vetëfinancim. Financimi i borxhit publik nëpërmjet instrumentave të thesarit, kryesisht është bërë nëpërmjet tregjeve parësore të mundësuar nga Banka e Shqipërisë dhe institucione të tjera.

Zhvillimi i tregjeve dytësore në vendin tonë është një mungesë e dukshme, që përfaqësohet vetëm nga transaksionet e tregjeve sekondare të bonove të thesarit apo obligacioneve të thesarit. Këto transaksione janë kryesisht transaksione ndërbankare dhe në total shfaqin karakteristikat e një tregu “të pakicës”, për shkak kryesisht të volumit të ulët të transaksioneve. Zhvillimi i tregut dytësor të instrumentave financiarë qeveritar është një mjet apo strategji efiçente për menaxhimin e borxhit publik por edhe detyrimeve të prapambetura.

Në këtë punim autorët do të studiojnë tregjet dytësore të instrumentave të thesarit dhe modelet e zhvillimit të tij, duke analizuar më specifikisht ndikimin në efikasitetin e menaxhimit të borxhit publik dhe premisat e zgjerimit të këtij tregu sekondar. Metodologjia e përdorur do të jetë analizë përshkruese dhe empirike në përputhje me modelet e zhvillimit që shfaq tregu sekondar në vendin tonë.

***Fjalët kyçe:*** *Treg sekondar, instrumenta qeveritar, analizë, model zhvillimi, borxh publik.*

---

<sup>1</sup> *Departamenti i Financës, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës*  
*E-mail: [ines.dika@virgilio.it](mailto:ines.dika@virgilio.it)*

<sup>2</sup> *Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit*  
*E-mail: [lleshajarjana@yahoo.com](mailto:lleshajarjana@yahoo.com)*